

Shtojca: Aktivitetet e lejueshme në kuadër të GZhSh-ve

Kjo listë vlen si për shkollat e përzgjedhura pa konkurs ashtu edhe për ato me konkurs. Lista nuk është shteruese, por e përcakton orientimin e aktiviteteve të lejueshme për financim.

Shkollat nuk mund ta shpenzojnë të gjithë grantin e tyre për blerjen vetëm të mjeteve fizike, dhe se kjo kategori kufizohet deri në 40% ose më pak të shumës së grantit. Mjetet fizike, për qëllim të GZhSh-ve, nënkuptojnë të gjitha mjetet mësimore (p.sh. mjetet eksperimentale për laboratorë, pajisjet e TI-së, burimet fizike dhe onlajn për biblioteka, pajisjet muzikore dhe sportive, etj.). Pjesa e tjetër duhet të shpenzohet në aktivitete të tjera, (p.sh. zhvillim profesional, aktivitete të nxënësve, etj.) – shembull: shkolla A dhe B më poshtë. Në rast të trajnimeve apo të aktiviteteve me nxënës, shkolla mund ta shpenzojë deri në 100% të grantit në aktivitete të tilla – shembull: shkolla C më poshtë.

Shembull	Shuma e grantit	Përqindja	Shuma deri në	Qëllimi
Shkolla A	\$15,000	60%	\$9,000	Materiale didaktike (20%) IT
		40%	\$ 5,000	Aktivitete (p.sh. trajnime, këshillime, etj.)
Shkolla B	\$15,000	78%	\$11,700	Aktivitete (p.sh. trajnime, këshillime, etj.)
		22%	\$ 3,300	Mjete fizike (p.sh. kompjuterë, laboratorë)
Shkolla C	\$ 15,000	100%	\$15,000	Aktivitete (p.sh. trajnime, këshillime, etj.)

1.1.1 Lista pozitive

Në vijim po e japim një listë jo detyruese e aktiviteteve të lejueshme për financim përmes nënkomponentit të GZhSh-ve:

- Aktivitete që e mbështetin shkollën të bëhet gjithëpërfshirëse, të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët, që e ngritin cilësinë e mësimdhënies dhe mësim-nxënies, që i mundësojnë t'i menaxhojë me efikasitet burimet e veta, të bëhet më e qasshme për të gjithë, si dhe të ofrojë shkathtësi për mësim gjatë gjithë jetës;
- Aktivitete që kanë për synim krijimin e një programi efektiv dhe të qëndrueshëm në nivel shkolle për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Programe të trajnimit për mësimdhënës dhe për administrues të shkollave (p.sh. trajnime për metodologjitë e reja, teknika, metoda e praktika të vlerësimit të nxënësve; si t'i përfshijmë nxënësit dhe prindërit në vlerësimin e nxënësve; si t'i përpilojmë planet mësimore; si ta menaxhojmë klasën; si t'i përdorimin teknologjitë e reja për zhvillim profesional; si t'i shfrytëzojmë mjetet dhe pajisjet mësimore në klasë; si ta menaxhojmë shkollën me efikasitet; si ta hartojmë një plan të qëndrueshëm financiar; si ta inkurajojmë komunitetin që të kontribuojë në zhvillimin e shkollës, etj.). Programet e trajnimit duhet të zgjidhen prej kurseve të akredituara nga MASHT-i;
- Aktivitete që kanë për synim ngritjen e kapaciteteve të shkollës në zbatimin e kurrikulës shtetërore;

- Krijimi i programeve dhe i aktiviteteve përmirësuese të nxënësve (rritja e mundësive të nxënësve si individë dhe si grup për të marrë pjesë aktive në aktivitetet mësimore përmes fushatave; programet të mentorimit; këshillimi, mentorimi, shfrytëzimi i instrumenteve onlajn, laboratorët; realizimi i orëve përforcuese, aktivitet për krijimin dhe zbatimin e planeve personale të nxënësve, etj.);
- Aktivitetet jashtë kurrikulare, si udhëtimet/vizitat dokumentare, të cilat e mbështesin procesin e mësim-nxënies të nxënësit (p.sh. në këto aktivitete mund të bëjnë pjesë aktivitete mësimore të bazuara në projekte, si vizitat në terren për të mbledhur informata për florën dhe faunën e rajoneve të caktuara në Kosovë si pjesë e fushës mësimore të shkencave natyrore, apo një projekt i historisë gojore për të mësuar më shumë për problemet gjuhësore apo traditën lokale si pjesë e fushës mësimore të gjuhës dhe komunikimit dhe të shoqërisë e mjedisit), pjesëmarrja në konkurse të ndryshme, dhe aktivitete të tjera të përbashkëta të shkollave që kanë për synim shkëmbimin e praktikave më të mira mes shkollave në çështje si, për shembull, zbatimin e kurrikulës së re, menaxhimi i shkollës dhe planifikimi, angazhimi i komunitetit lokal, ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve në nivel shkolle, etj.;
- Aktivitete për zhvillim profesional (takime të bashkëpunimit, konferenca, seminare) të mësimdhënësve që t'i shkëmbejnë përvojat e tyre dhe të mësojnë prej kolegëve të tjerë. Aktivitetet e tilla duhet të kufizohet vetëm brenda kufijve të Kosovës dhe të kontribuojnë drejt qëllimeve të projektit;
- Pajisje dhe mjete mësimore (p.sh. instrumentet eksperimentale për laboratorët e shkencave, teknologjia e informacionit që e mbështet procesin e mësimdhënies dhe mësim-nxënies, instrumente muzikore, pajisje sportive, burimet dhe pajisje për biblioteka, etj.), të cilat nuk e kalojnë shumën maksimale prej 40% të shumës së përgjithshme të grantit të fituar. Këto pajisje dhe mjete janë përkufizuar si mjete fizike për qëllim të GZhSh-ve;
- Realizimi i aktiviteteve komunikuese mes shkollës dhe komunitetit (p.sh. radiot e shkollave, ueb-sajte dhe aplikacione interaktive të shkollave, buletinë të shkollave, etj.).

1.1.2 Lista negative

Më poshtë po japim një listë të aktiviteteve që nuk janë të lejueshme të financohen në kuadër të granteve për zhvillimin e shkollave:

- Infrastruktura – punime të çfarëdo lloji, përfshirë edhe riparimet e vogla;
- Shtesa në roga (të rregullta apo jashtë orarit) apo honorarë, mëditje, apo ndonjë shumë tjetër për personelin e rregullt të përfshirë në zbatimin e projektit;
- Aktivitete që *nuk* përkojnë me objektivat e GZhSh-ve dhe me prioritetet e planeve për zhvillimin e shkollave;
- Shpenzime komunale (si rryma, uji, ngrohja, etj.) dhe ato harxhuese, të cilat janë pjesë e buxhetit të rregullt vjetor të shkollës;
- Aktivitete, të cilat shkojnë përtej qëllimeve arsimore, posaçërisht ato politike ose ekonomike;
- Aktivitete që pa të drejtë i diskriminojnë grupet etnike apo grupet e tjera;
- Fushata për mbledhje fondesh dhe projekte të ndihmave humanitare.